

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8302  
E shtunë, 16 maj 2026  
Çmimi 0.50 €

**OVLUÇK-ja: Ajo çfarë ndodhi në Skenderaj ishte skenar i porositur nga Kurti dhe banda e tij**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## A DUHET PARTITË TA PARAQESIN NGA NJË EMËR PËR PRESIDENT PARA ZGJEDHJEVE TË QERSHORIT?

FAQE 4-5



Derisa Kosova po përgatitet për zgjedhjet e reja parlamentare, që u shkaktuan nga dështimi i Kuvendit

për ta zgjedhur kreun e ri të shtetit, çështja e presidentit mbetet një nga nyjat kryesore politike pa

zgjidhje. A rrezikon Kosova të përballlet me një tjetër krizë politike menjëherë pas zgjedhjeve?

### AKTUALE



**SHOIPËRIA BËHET GATI PËR TË DËRGUAR TRUPA NË GAZË F. 2**

**TA PRANOSH ME DASHURI DHE PËRKUSHTIM FËMIJËN AUTIK, NJË SFIDË NDREYSHË BISEDË ME NAKIJE UKËN F. 6**

**SUPREMJA SHFUQIZON NENIN E RREGULLORES SË MASHTI-T PËR PËRZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSVE F. 3**

### EKONOMI



**AEROPORTI ME RITJJE TË UDHËTARËVE, HEKURUDHA ME RËNIE GJATË MARSIT 2026 F. 8**

**INTEGRIMI NË SEPA PRITET TË SJELLË PAGESA MË TË SHPEJTA, MË TRANSPARENTE DHE ME KOSTO MË TË ULËT PËR QYTETARËT DHE BIZNESET F. 8**

### SPORT



**KOSOVA DHE SHOIPËRIA SHTOJNË BASHKËPUNIMIN PËR LOJËRAT MESHETARE 'PRISHTINA 2030' F. 24**



**KOS BËN THIRRJE PËR INSTITUCIONE TË QËNDRUESHME, NË MËNYRË QË KOSOVA TË ECË PËRPARA DREJT BE-së F. 3**

**AKK-ja: KOMUNAT NËN PRESION FINANCIAR, KËRKOHEM KOMPENSIM PËR BARRËN E KONTRATËS KOLEKTIVE F. 7**



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Policia Ushtarake ngrit kapacitetet operacionale

PRISHTINË, 15 MAJ - Forca e Sigurisë së Kosovës ka njoftuar se në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të Policisë Ushtarake është realizuar për herë të parë Kursi për Intervenime dhe Kontrollim të Turmave, realizuar në bashkëpunim me instruktorë nga Policia Ushtarake Kroate. Ky trajnim shënon një hap të

rëndësishëm pasi që për herë të parë është integruar moduli i specializuar për intervenime, kontroll të turmave dhe luftime në hapësira të mbyllura (CQB) të Policisë Ushtarake. Gjatë trajnimit pjesëtarët i janë nënshtruar një programi intensiv që ka ndërthurur njohuritë teorike me ato praktike, me aspektin në

intervenime të shpejta dhe luftime në hapësira të mbyllura. Ky kurs dëshmon transformimin e vazhdueshëm të Policisë Ushtarake në një njësi të gatshme për t'u ballafaquar me sfidat komplekse të sigurisë dhe për të vepruar në mjedise të ndryshme operacionale.



## SHQIPËRIA BËHET GATI PËR TË DËRGUAR TRUPA NË GAZË

TIRANË, 15 MAJ - Shqipëria po përgatitet për t'u angazhuar në Rripin e Gazës, në kuadër të Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit. Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Ermal Nufi, tha në një konferencë për medie në Tiranë se një skuadër shqiptare ka parë situatën në terren. "Në kuadër të angazhimit në Bordin e Paqes, Shqipëria ka marrë masa për shqyrtimin e situatës në Gaza. Rripi i Gazës është nën sigurinë e Forcave të Mbrojtjes së Izraelit [IDF] dhe çdo lloj inspektimi trupash atje bëhet përmes Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese dhe ushtrisë izraelite. Kemi dërguar një skuadër për të parë nga afër vendndodhjen dhe situatën në terren, që të kuptojmë se ku dhe si mund të vendosemi", u shpreh ai.

Forca Ndërkombëtare Stabilizuese buron nga një plan 20-pikësh i presidentit amerikan Donald Trump për t'i dhënë fund luftës mes Izraelit dhe Hamasit -

grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Rripin e Gazës. Nufi bëri me dije se Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë ka përgatitur planin konkret që pritet të zhvillohet në disa nivele dhe faza sa i përket angazhimit të Shqipërisë në Gazë, por nuk zbuloi më shumë rreth tij. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Arben Kingji, tha se aktualisht Shqipëria është në fazën e procedimit dhe hartimit të praktikës dhe dokumenteve ligjore për dërgimin e trupave në mision. "Shtabi i Përgjithshëm po bën vlerësimin e saktë në lidhje me misionin, detyrat, sigurinë e personelit, rregullat e angazhimit dhe mbështetjen logjistike. Kontingjenti i parë shqiptar që mund të dislokohet në Gazë do të jetë pjesë e shtabit të Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese, ndërsa më pas do të shqyrtohet mundësia e një kontributi më të gjerë me trupa",



u shpreh Kingji. Në fillim të majit u bë me dije se një ekip ushtarak të Kosovës është dërguar në Gazë, për ta bërë vlerësimin e vendit ku do të veprojë si pjesë e misionit paqeruajtës. Ministri Nufi theksoi se Shqipëria mbetet një aleate e palëkundur e NATO-s dhe një partnere aktive në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare. Duke folur për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes mes

Shqipërisë, Kosovës dhe Kroacisë - shtete që kanë nënshkruar një deklaratë bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes vitin e kaluar - po hyn në një fazë më konkrete, me zhvillimin e tre stërvitjeve të përbashkëta ushtarake gjatë këtij viti. "Dy stërvitje do të zhvillohen në Kroaci ku jemi në fazën e planifikimit, kemi dhënë dakordësinë për t'u zhvilluar stërvitjet. Po kështu, një stërvitje

do të zhvillohet në Shqipëri. Nuk do të jenë vetëm tre shtete pjesëmarrëse [Shqipëri-Kosovë-Kroaci], por do të ketë edhe shtete të tjera nga NATO-ja, qoftë edhe shtete partnere me të cilat bashkëpunojmë", tha Kingji.

Bashkëpunimin mes Prishtinës, Tiranës dhe Zagrebit, Serbia e sheh si aleancë kundër serbëve dhe Serbisë - pretendim që është hedhur poshtë nga shtetet nënshkruese të deklaratës për bashkëpunim. Po ashtu, autoritetet e mbrojtjes bënë me dije se Shqipëria ka nisur zyrtarisht përgatitjet për organizimin e samitit të NATO-s që do të mbahet vitin e ardhshëm në Tiranë. "Kemi ngritur një task-forcë për zhvillimin e samitit të NATO-s. Nuk e kemi ende të përcaktuar vendndodhjen e samitit, por NATO merr masa të jashtëzakonshme sigurie për organizimin e këtyre ngjarjeve", deklaroi ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Ermal Nufi.

## TRUMPI: MUND TË PRANOJMË NJË NDALIM 20-VJEÇAR TË PROGRAMIT BËRTHAMOR TË IRANIT



WASHINGTON, 15 MAJ - Presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar se mund të mbështesë një marrëveshje që do ta ndalte aktivitetin bërthamor të Iranit për një periudhë 20-vjeçare, duke theksuar se garancitë nga Teherani duhet të jenë të besueshme dhe të zbatueshme. "20 vjet janë të mjaftueshme. Por niveli i garancisë nga ana e tyre... duhet të jetë një periudhë reale prej 20 vitesh", tha Trumpi në një

deklaratë për medie. Komentet e liderit amerikan vijnë në një kohë tensionesh të vazhdueshme lidhur me programin bërthamor të Iranit dhe përpjekjeve ndërkombëtare për të arritur një marrëveshje të re mbi kufizimin e aktiviteteve atomike të Teheranit. Trumpi nuk dha hollësi konkrete mbi formën e mundshme të marrëveshjes, por deklarata e tij sugjeron një qasje më fleksibile

krahasuar me qëndrimet e mëparshme të ashpra ndaj Iranit.

Çështja e programit bërthamor iranian mbetet një nga temat kryesore në politikën e jashtme amerikane dhe në marrëdhëniet në mes të Uashingtonit dhe Teheranit.

Ndryshe, ShBA-ja dhe Irani kanë arritur kohë më parë një armëpushim pa afat të caktuar pas disa javësh lufte.

## Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe Biblioteka Nazionale Marciana në Venecia arrijnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 15 MAJ - Në kuadër të projektit bilateral Kosovë - Shqipëri "Modalitete kërkimore në arkivat e Venecias", u nënshkrua marrëveshja e parë e bashkëpunimit ndërmjet

Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Bibliotekës Nazionale Marciana në Venecia. Gjatë vizitës zyrtare në Itali, delegacioni nga Kosova mori pjesë në një trajnim intensiv me

ekspertë të bibliotekave dhe arkivave të Marcianas, me fokus në shkëmbimin e përvojave profesionale dhe avancimin e bashkëpunimit në fushën e bibliotekarisë dhe trashëgimisë

kulturore. Ky bashkëpunim hap rrugë për projekte të përbashkëta dhe promovim të mëtejshëm të trashëgimisë sonë kulturore në nivel ndërkombëtar.



# KOS BËN THIRRJE PËR INSTITUCIONE TË QËNDRUESHME, NË MËNYRË QË KOSOVA TË ECË PËRPARA DREJT BE-së

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 MAJ - Komisionarja për Zgjerim e Bashkimit Evropian (BE), Marta Kos, i ka bërë thirrje spektrit politik në Kosovë, gjatë një vizite në Prishtinë, të gjejë gjuhë të përbashkët për t'i dhënë fund ngërçit të gjatë institucional dhe të formojë institucione të qëndrueshme, në mënyrë që vendi të ecë përpara drejt bllokut evropian. Kos në vizitën e saj të parë në Kosovë, pas marrjes së detyrës më 2024, u prit të premten nga ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, para se të takohet me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti.

Duke folur në një konferencë për medie përkrah Kurtit, Kos tha se "nuk ka siguri në Evropë pa Kosovën". Por, ajo tha se Kosova, e cila ende nuk e ka statusin e vendit kandidat për t'u anëtarësuar në bllok, duhet të ketë sa më parë institucione të qëndrueshme dhe funksionale.

"Thirrja ime e qartë në këtë vizitë është për të gjithë aktorët politikë për ta gjetur një mënyrë për ta kthyer stabilitetin institucional", tha Kos.

Vizita e saj po zhvillohet në një kohë kur vendi ka institucione në detyrë pasi është në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të caktuara për 7 qershor.

Këto janë zgjedhjet e treta të

njëpasnjëshme pas atyre në shkurt dhe dhjetor 2025, të cilat kanë ngadalësuar reformat kyçe dhe kanë krijuar kosto të vazhdueshme financiare për buxhetin e shtetit.

Kos tha se shumë reforma kanë ngecur për shkak të përsëritjes së zgjedhjeve dhe Kosova duhet ta zërë hapin pas një vitit të humbur më 2025.

"Është e rëndësishme që pasi të bëhet Kuvendi i ri, liderët politikë në Kosovë të bashkohen dhe t'i themelojnë të gjitha institucionet, përfshirë zgjedhjen e presidentit të ri përmes kompromisit dhe t'i japin fund këtij ngërçi të gjatë institucional", tha ajo.

"Kosova ka një perspektivë të madhe evropiane. Dhe për mua personalisht, unë jam e etur për ta rritur intensitetin e punës me Kosovën pasi të jenë formuar institucionet e reja", theksoi Kos.

Kurti, në anën tjetër, tha se "patëm një takim produktiv dhe të drejtpërdrejtë".

Ai tha se në takim me Kosin e ngriti çështjen e statusit të vendit kandidat për Kosovën dhe të hapjes së negociatave me bllokun. "Janë bërë mbi 40 muaj që kur kemi aplikuar dhe momenti i ripërtërirë i zgjerimit të Bashkimit Evropian duhet të reflektojë me avancimin e meritur të Kosovës. Mbështetja publike për Bashkimin Evropian për anëtarësim në BE qëndron vazhdimisht rreth 90 % në



vendin tonë dhe është ndër më të lartat nga të gjitha vendet candidate", tha Kurti.

Kurti theksoi se vendi po punon me shtetet anëtare, por kërkoi nga BE-ja ta shtyjë përpara unitetin brenda bllokut për çështjen e Kosovës. "Zgjerimi është mjeti më i suksesshëm i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian. Vakuumi që lë Bashkimi Evropian po synohet që të mbushet nga aktorë të tjerë dashakeq, të cilët i minojnë vlerat e Bashkimit Evropian dhe rrezikojnë sigurinë tonë të

përbashkët, prandaj është përgjegjësi e të gjithë neve që Kosova të avancojë në procesin e integritimit", tha ai.

Ndërkaq ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, ka treguar se me Marta Kos, biseduan për rrugën evropiane të Republikës së Kosovës, për reformat që duhet të çohen përpara dhe për rëndësinë që procesi i zgjerimit të jetë i drejtë, i besueshëm dhe i bazuar në merita.

"Kosova e sheh të ardhmen e saj në Bashkimin Evropian. Ky është orientim i qytetarëve

tanë, projekt shtetëror dhe zgjedhje strategjike. Prandaj, presim që përkushtimi ynë ndaj demokracisë, sundimit të ligjit dhe vlerave evropiane të gjejë përgjigje të qartë edhe nga Bashkimi Evropian. E falënderova komisionaren Kos për vizitën dhe për angazhimin e saj në procesin e zgjerimit. Kosova mbetet e përkushtuar për bashkëpunim të ngushtë me institucionet e BE-së, në interes të qytetarëve tanë dhe të një Evrope më të plotë, më të sigurt dhe më demokratike", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

## SUPREMJA SHFUQIZON NENIN E RREGULLORES SË MASHTI-T PËR PËRZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSVE

PRISHTINË, 15 MAJ - Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës, në çështjen juridike të konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit: Këshilli Drejtues i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Xhavit Ahmeti", kundër të paditurave: Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), me objekt shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, përkatësisht neni 21 të Rregullores (QRK) nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtoreve dhe Zëvendës Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit



Parauniversitar, pas shqyrtimit gjyqësor publik, ka aprovuar si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit.

Përmes një njoftimi për medie

thuhet se është shpallur i paligjshëm dhe është shfuqizuar neni 21 i Rregullores (QRK) nr. 19/2024, e miratuar me Vendimin nr.

03/212 i datës 10.07.2024, ndërsa është refuzuar kërkesa e paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit. "Gjykata Supreme vlerëson se qeveria ka pasur kompetencë kushtetuese dhe ligjore për nxjerrjen e rregullores në fjalë, mirëpo dispozita e kontestuar, përkatësisht neni 21 i saj, nuk është në përputhje me nenin 35 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës", thuhet në njoftim. Ndërkaq, siç thuhet në njoftim, Ligji për Arsimin Parauniversitar, si ligj i veçantë (lex specialis), përcakton qartë se përzgjedhja e mësimdhënësve bëhet nga një komision i themeluar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, ku përfshihen edhe drejtori i institucionit arsimor dhe

përfaqësuesit e Këshillit Drejtues. "Ndërsa neni 21 i Rregullores nr. 19/2024 kishte ndryshuar këtë përbërje duke përjashtuar këta përfaqësues, duke rënë ndesh me dispozitat ligjore në fuqi dhe me parimin e hierarkisë së akteve juridike. Rregullorja në fjalë, respektivisht neni 21 i saj, rezulton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, pasi ndryshon përbërjen e organit vendimmarrës të përcaktuar me ligj, duke përjashtuar subjektet që ligji i konsideron pjesë përbërëse të domosdoshme të këtij procesi. Gjykata Supreme thekson se aktet nënligjore duhet të jenë në funksion të zbatimit të ligjit dhe nuk mund të ndryshojnë apo kufizojnë dispozitat e përcaktuara me ligj", thuhet në njoftim.



# A DUHET PARTITË TA PARAQESIN NGA NJË EMËR PËR PRESIDENT PARA ZGJEDHJEVE TË QERSHORIT?

Derisa Kosova po përgatitet për zgjedhjet e reja parlamentare, që u shkaktuan nga dështimi i Kuvendit për ta zgjedhur kreun e ri të shtetit, çështja e presidentit mbetet një nga nyjat kryesore politike pa zgjidhje. A rrezikon Kosova të përballet me një tjetër krizë politike menjëherë pas zgjedhjeve?

**PRISHTINË, 15 MAJ** - Moszgjedhja e kreut të ri të shtetit në Kosovë shtoi paqëndrueshmërinë institucionale në vend këtë vit, duke nxitur zgjedhje të reja parlamentare pas një viti të humbur më 2025. Dhe ky jostabilitet mund të thellohet në mungesë të kandidatëve të qartë për postin e presidentit dhe të pagitshmërisë së partive politike për të bërë lëshime. Pavarësisht se nuk zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, a do të mund të lehtësohej emërimi i një presidenti të ri nëse partitë paraqesin nga një kandidat para zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit?

## Cilat parti kanë paraqitur kandidat për president?

Vetëm Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në opozitë ka bërë me dije se bartësja e listës së saj zgjedhore, Vjosa Osmani, në kuadër të një bashkëpunimi parazgjedhor, do të jetë kandidate e saj për

presidente. Osmani kërkon një mandat të dytë në krye të shtetit, pas dështimit për t'u rikandiduar në prill. Partitë e tjera të mëdha, si Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në pushtet dhe partia kryesore opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk kanë paraqitur kandidatë. Derisa partitë nuk janë të obliguara ta paraqesin ndonjë kandidat për president para zgjedhjeve, ato do të duhej të zotoheshin së paku për karakteristikat e profilit të kandidatit për president, apo për parimet të cilat do t'i udhëhiqnin në arritjen e një konsensusi politik, thotë Agon Maliqi, njohës i çështjeve politike në Kosovë. "Duhet t'i sqarojnë saktë rrethanat në të cilat ata do të ishin dakord për një president, dhe cilat karakteristika duhet t'i ketë ai president, në mënyrë që të shmangen sërish zgjedhjet. Në bazë të këtij zotimi pastaj mund të kërkohet llogaridhënie prej tyre pas

zgjedhjeve", shprehet Maliqi për Radion Evropa e Lirë (REL). Në praktikë kjo do të nënkuptonte më shumë transparencë politike para zgjedhjeve dhe më pak improvizim pas tyre.

## Pse LDK po e partitë e tjera jo?

As partia në pushtet e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, e as PDK-ja nuk iu përgjigjën pyetjeve të REL-it nëse do ta bëjnë publike ndonjë kandidat për presidentin e ardhshëm të Kosovës. Maliqi beson se LDK-ja e paraqiti kandidatin për shkak të "rrethanave specifike" të ish-presidentes Osmani, ndërsa partitë e tjera nuk po e bëjnë sepse s'e kanë kandidatin e qartë e as s'e ndiejnë ngutësinë për ta bërë tani. "Mendoj se LDK-ja e ka bërë, me gjasë, nga bindja se narracioni i viktimizimit të saj nga ana e Kurtit mund të ngjallë emocione te një lloj votuesi, i cili në dhjetor ka votuar për LV-në për shkak të binomit Kurti-Osmani, dhe jo vetëm për Kurtin", shpjegon Maliqi. Edhe sikur të kishte kandidatura tani, sipas Maliqit, ato do të mund të dukeshin "artificiale". Ai argumenton se

veçanërisht kur bëhet fjalë për presidentin - në mos edhe për pozita të tjera - do të ketë nevojë për lëshime mes partive. Sepse zgjedhja e presidentit në Kosovë rrallëherë është proces që zgjidhet nga rezultati elektoral - ajo zakonisht kërkon marrëveshje politike, kompromis dhe lëshime ndërmjet partive. Pikërisht këtu qëndron problemi kryesor: partitë po hyjnë në zgjedhje pa asnjë marrëveshje për pozitën që mund ta përcaktojë stabilitetin institucional të vendit për vitet e ardhshme.

## Një proces që kërkon kompromis

Kosova ka vuajtur nga mungesa e kompromiseve mes partive në vitet e fundit dhe zgjedhja e presidentit në këtë kohë duket detyrë jo edhe aq e lehtë. Vendi e humbi tërë vitin 2025 si pasojë e mosthemelimit të Kuvendit fillimisht, pastaj të qeverisë, në mungesë të konsensusëve - dhe zgjedhjet po mbahen sërish brenda një kohe të shkurtër për shkak të mospajtimeve për presidentin, pa asnjë garanci se çfarë do të ndodhë tutje. LV-ja, në pushtet që nga viti 2021, shihet sërish favorite për

t'i fituar zgjedhjet, por ajo nuk parashihet t'i marrë vetë 80 vende në Kuvendin me 120 sosh. Që votimi për presidentin e Kosovës të jetë i vlefshëm, nevojitet prania e 2/3 të të gjithë deputetëve në Kuvend. Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë për Radion Evropa e Lirë se Kosovës po i mungon një debat i mirëfilltë politik ndërmjet pozitës dhe opozitës për tema strategjike shtetërore, përfshirë edhe çështjen e presidentit. "Në këtë aspekt zgjedhja e presidentit në Kosovë duhet të shihet si proces që kërkon komunikim politik, kompromis demokratik dhe transparencë ndaj publikut, e jo si çështje që adresohet përmes listave të dëshirave apo imponimit", thekson Miftaraj. Për të gjitha krizat institucionale brenda një viti e gjysmë, partia në pushtet dhe ato në opozitë e kanë fajësuar njëra-tjetrën. Në fund, presidenti i ardhshëm mund të mos përcaktohet nga emrat që partitë shpallin para zgjedhjeve, por nga gatishmëria e tyre për kompromis kur të përballen me realitetin parlamentar pas 7 qershorit. Deri në zgjedhjen e presidentit funksionin do të vazhdojë ta ushtrojë Albulena Haxhiu, detyra gjashtëmujore e së cilës zgjat më së largu deri në tetor.

# OVLUÇK-ja: AJO ÇFARË NDODHI NË SKENDERAJ ISHTE SKENAR I POROSITUR NGA KURTI DHE BANDA E TIJ



Prishtinë, 15 maj - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka mbajtur një takim urgjent ku është diskutuar për “përkeqësimin e klimës së sigurisë” pas angazhimit të njëjësive speciale në një incident që ka ndodhur në Skenderaj, të cilin e ka cilësuar si “zënkë të zakonshme e pa pasoja të rënda”. OVLUÇK-ja ka thënë se strukturat e sigurisë së Kosovës “ekzistojnë për të mbrojtur qytetarët dhe rendin kushtetues, e jo të marrin pjesë në shtetrrëthime e ngjallje të frikës”.

Ata u kanë bërë thirrje pjesëtarëve të Policisë së Kosovës që “të mos harrojnë se mandati i tyre buron nga Kushtetuta dhe ligjet, e jo nga urdhrat qeveritare në dobi të zbatimit të skenarëve të porositur nga Albini Kurti dhe banda e tij”. “Të jemi të qartë. Strukturat e sigurisë së Republikës ekzistojnë për t’i

mbrojtur qytetarët dhe rendin kushtetues e jo të marrin pjesë në shtetrrëthime e ngjallje të frikës. Me këtë rast u drejtohem pjesëtarëve të Policisë të mos harrojnë se mandati i tyre buron nga Kushtetuta dhe ligjet, e jo nga urdhrat qeveritare në dobi të zbatimit të skenarëve të porositur nga Albini Kurti dhe banda e tij”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së. Sipas këtij reagimi, “nëse uniforma e Kosovës kthehet në instrument për të vendosur tiraninë e regjimit, atëherë përpos urdhërdhënësve, përgjegjësia bëhet edhe personale”.

OVLUÇK-ja ka deklaruar se “në mbrojtje të lirisë, demokracisë e rendit kushtetues, me çdo mjet do të pengojmë secilin individ apo organizim politik që tenton të vendosë diktaturën”. Kjo organizatë ka thënë se “diktatura mori fund në qershor të vitit 1999” dhe

shtoi se janë “të gatshëm gjithmonë të sakrifikohen në mbrojtje të lirisë dhe shtetit”. “Kushdo që tenton ta vë këtë realitet në provë, le të urdhërojë. Këtu jemi. Të gatshëm gjithmonë të sakrifikohemi në mbrojtje të lirisë dhe shtetit që ka në themele mundin e luftëtarëve e gjakun e dëshmorëve të UÇK-së”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

**Rasti në Skenderaj,  
IKD-ja: Strukturat  
policore në asnjë  
rrethanë nuk duhet të  
përdoren për demonstrim  
force politike**

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka shprehur shqetësim lidhur me zhvillimet e fundit dhe angazhimin e Njëjësive Speciale të Policisë së Kosovës

në Skenderaj, në rrethana që, sipas IKD-së, kanë krijuar perceptim të ndërhyrjes politike dhe instrumentalizimit të policisë për interesa partiake apo politike, duke shkaktuar shqetësim te qytetarët në Skenderaj dhe publiku në Kosovë.

Në reagim thuhet se Policia e Kosovës mbetet një ndër institucionet më të besueshme në Republikën e Kosovës dhe ky besim dhe kjo mbështetje për Policinë e Kosovës nuk duhet të keqpërdoren dhe shfrytëzohen për interesa partiake dhe politike. “IKD thekson qartë se dënon çdo formë të dhunës fizike, nga kushdo që kryhet dhe ndaj kujtudo që drejtohet. Personat e dyshuar për sulmin në fjalë duhet të trajtohen nga organet kompetente dhe të mbahen përgjegjës sipas ligjit. Drejtësia në raste të tilla duhet të jetë efektive, efektive dhe e paanshme, përmes procedurave

të rregullta policore dhe hetimore, siç ndodh në rrethana normale për raste të ngjashme, dhe jo përmes pamjeve të mobilizimit të njëjësive speciale që krijojnë shqetësim te qytetarët, tensionojnë situatën në terren dhe japin përshtypjen e përdorimit të forcës policore për menaxhim politik të një incidenti të veçantë. Pavarësia profesionale dhe operative e Policisë së Kosovës përbën një ndër shtyllat kryesore të shtetit demokratik dhe sundimit të ligjit. Strukturat policore nuk mund dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të përdoren për demonstrim force politike, presion institucional apo menaxhim politik të një rasti të vetëm. Kjo qasje dëmton seriozisht besimin e qytetarëve në institucionet e sigurisë dhe cenon parimet themelore të funksionimit demokratik të shtetit”, thuhet në reagimin e IKD-së.

BISEDË ME NAKIJE UKËN

# TA PRANOSH ME DASHURI DHE PËRKUSHTIM ËMIJËN AUTIK, NJË SFIDË NDRYSHE



Nga Mimoza CIKA

Autizmi nuk është “faj” i askujt. Fëmija nuk ka nevojë të ndihet se është problem për t’u rregulluar, por person që ka nevojë për mbështetje dhe kuptim.

Autism Spectrum Disorder është një mënyrë e ndryshme e zhvillimit të trurit. Disa fëmijë kanë nevoja shumë të mëdha për mbështetje, ndërsa të tjerë funksionojnë mirë me ndihmën e duhur. Për shumë familje që kanë një fat të tillë e shohin këtë rast si një dramë, pësojnë fillimisht një tronditje të madhe apo kanë një frikë për të ardhmen. Disa të tjerë e shohin si një sfidë që me durim mund të përballohet.

Ajo që shpesh e bën situatën të ndihet si e tillë nuk është vetë autizmi, por mungesa e mbështetjes, paragjykimi nga shoqëria, izolimi, apo mungesa e shërbimeve profesionale si në Shqipëri apo Kosovë. Megjithatë shumë fëmijë me autizëm zhvillojnë aftësi të mira komunikimi, mësojnë, krijojnë marrëdhënie dhe jetojnë jetë të plota, sidomos kur marrin mbështetje herët dhe kur familja nuk i sheh vetëm përmes vështirësive. Prandaj, është normale të ndihen emocione të forta, por nuk duhet të përjetohet si tragjedi. Shpesh bëhet një rrugëtim i ndryshëm nga ai që prindërit kishin imagjinuar, jo domosdoshmërisht një jetë më pak me vlerë.

Të kesh një fëmijë me autizëm

mund të jetë sfidë e madhe emocionale, praktike dhe financiare për familjen, por nuk duhet parë automatikisht si “dramë” apo fund i jetës normale. Të paktën kështu mendon Nakije Uka, e cila jeton në Këln të Gjermanisë. Ajo është lindur dhe rritur në Skenderaj të Kosovës në një familje të madhe me 9 fëmijë dhe prej vitit 2013 jeton në Gjermani e martuar me Istref Ukën dhe dy fëmijët e saj, Lorena dhe Luani. Fati e desh që Luani sot nëntëvjeçar të diagnostikohet me autizëm. Por çfarë do të thotë të jesh prind i një fëmije të tillë, edhe pse në Gjermani?

“Luani është fëmija i dytë pas Lorenës dhe lindja ka qenë normale. Fillimisht nuk dalluam asgjë, por kur ai ishte dy vjeç e më pas tre vjeç fillova të dalloja disa veprime ndryshe. Nuk reagonte si duhet me sytë, nuk qeshte dhe nuk po fliste fare. Mendova se ndoshta si djale flet më vonë, por nga kontrollet tek mjeku u vu re që diçka nuk është në rregull. Pas shumë kontrollesh e testesh të ndryshme nëpër institucionet mjekësore, u arrit në përfundimin se Luani është autik. Unë në fillim nuk e kuptova fjalën Autizëm, mendova se është në gjermanisht dhe e pyeta burrin tim se çfarë do të thotë. Ai më sqaroi dhe aty mu bë e qartë se unë do të isha tani e tutje nëna e një djali autik. Ishte një moment shumë i trishtë. Mu duk sikur u përmbys bota. Por shpejt e mblodha veten dhe thashë: Kjo është një dhuratë nga Zoti dhe

duhet ta pranoj si një gjë të shenjtë”, tregon Nakija me lot në sy duke shtuar se “Kjo e gjitha është një luftë me vetveten”. Pra një luftë në heshtje që e përjetojnë shumë nëna, shumë prindër me një fat të tillë. Ajo që të ndihmon më së shumti është informimi mbi këtë diagnozë, pra mbi autizmin. Të njihesh me raste të ndryshme dhe të kesh kontakte me nëna apo prindër të rasteve të tilla për të shkëmbyer eksperiencën. Kjo është fillimisht një ndihmë e madhe për çdo familje. Sigurisht që në Gjermani ka një sërë qendrash speciale për fëmijë të tillë që duhen vizituar rregullisht. Dhe të gjitha këto i ka bërë edhe Nakija me bashkëshortin dhe Luanin. Pas kopshtit special për të tillë fëmijë, sot Luani shkon në një shkollë speciale për të tilla raste. Prindërit natyrisht kanë pjesën e tyre të përditshme që merren me djalin, shpesh kjo shumë e lodhshme, e mbingarkuar dhe me plot sfida. “Të jesh nënë i një fëmije me aftësi të kufizuar, autik apo me aftësi të veçanta, nuk është e lehtë. Por edhe duke qarë e vajtuar për këtë nuk fitojmë gjë. Prandaj vendosa ta marrë veten në dorë dhe t’i përkushtohem me të gjitha forcat përkujdesjes së djalit duke i dhënë sa më shumë dashuri si një fëmijë i mirëpritur mes nesh. Kjo situatë kërkon mbi të gjitha durim, gjakftohtësi, vullnet dhe një angazhim të madh për tu bërë pjesë e shumë projekteve, aktiviteteve që ndihmojnë Luanin. Nuk është e lehtë

natyrisht, por njeriu është i çuditshëm, gjen forca dhe përshtatet me të gjitha vështirësitë, aq më shumë kur bëhet fjalë për një fëmijë të pafajshëm që erdhi në jetë jo si fëmijë normal”, thekson Nakija në bisedën tonë.

Sigurisht që pa mbështetjen e bashkëshortit Nakija vetëm nuk mund ta përballonte këtë sfidë. Për këtë ajo i është shumë mirënjohëse.

Ai përveç punës së tij që bën çdo ditë, gjen kohë për t’u marrë edhe me djalin. Nuk mungon në çdo takim me mjekët, mësuesit apo specialistët që kanë të bëjnë me Luanin. Gjithmonë ai i qëndron në krah Nakijes dhe Luanit, por edhe Lorenës 11-vjeçare që ka filluar të kuptojë çdo ditë e më shumë se vëllai i saj është ndryshe dhe që nuk mundet të luajë sikurse shoqet e saj me vëllezërit apo motrat. “Së bashku kemi arritur shumë dhe mendoj se duke qenë bashkë në çdo hap, edhe Luani do të jetë më mirë”, thotë me gëzim Nakija. Por ajo nuk mbron faktin që jeton në Gjermani, gjë që ja bën më të lehtë këtë sfidë. “Jam e bekuar që jetoj këtu pasi shteti i ndihmon shumë prindërit dhe fëmijët me autizëm. Gjithashtu këtu ka shumë parqe në natyrë dhe sheshe lodrash për fëmijë që kanë hapësirë dhe mundësi për të shijuar kohën e lirë të gjithë fëmijët pa dallim. Ndërsa në Kosovë apo Shqipëri, këto mungojnë. Shteti duhet të bëjë më shumë për familje me raste të tilla”, vazhdon më tej Nakija. Natyrisht që ka dhe do të ketë

ditë të vështira, por progresi shpesh ndodh gradualisht dhe në mënyra që në fillim nuk duken. Shumë prindër thonë se me kohën mësojnë jo vetëm si ta ndihmojnë fëmijën, por edhe si ta kuptojnë më mirë botën e tij.

“Të kesh një fëmijë autik do të thotë të bashkëjetosh njëkohësisht me vuajtjen dhe gëzimin. Vetëm duke vajtuar dhe qëndruar në vend nuk arrijmë asgjë. Të mos bëhemi vitkimë e kësaj sate; por të punojmë për t’ia bërë Luanit sa më të lehtë jetën. Dashuria aq e madhe të shtyn për të luftuar dhe shumë. Pra motoja jonë është si ta ‘mposhtim’ autizmin, si t’ia lehtësojmë Luanit jetën për shkak se i mungojnë shumë gjëra. Dhe ja kemi arritur. Ai që nuk mund të hante vetë dikur, sot është komplet i pavarur në tavolinën e ngrënies. Pra me shumë përpjekje kemi arritur diçka. Shpresojmë që ky rrugëtim i ynë të mos ndalet kurrë”, thekson me optimizëm Nakije Uka dhe vazhdon: “Ne si prindër duhet të mendojmë natyrisht edhe për vete për të qenë më të forta për ta përballuar këtë situatë. Ndaj apoj veçanërisht tek të gjitha nënat me fëmijë të tillë që të mos dorëzohen por të luftojnë me dashuri dhe durim. Çdo fëmijë zhvillohet ndryshe. Ta pranojmë fëmijën siç është pa e krahasuar vazhdimisht me fëmijët e tjerë. Të përqendrohemi te progresi i tij, edhe kur duket i vogël. Kjo është terapia më e mirë dhe forca jonë për ne si prindër”.

# KURTI ZOTOHET PËR RRIJJE TË SHITESAVE PËR FËMIJË NË MANDATIN TJETËR DERI NË 90 EURO

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka premtuar rritje të shtesave për fëmijë që t'i dyfishojnë deri në 90 euro dhe rritje të mbështetjes për lehonat deri në 500 euro në muaj gjatë mandatit të ardhshëm. Në tryezën e organizuar nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Familjes, Kurti tha të premten se mbi 400 mijë fëmijë kanë përfituar nga shtesat për fëmijë, ndërsa mbi 80 mijë nëna nga shtesat për lehona. Ai tha se zotimi i tyre është që

në mandatin e plotë, të cilin e synojnë edhe një herë, shtesat për fëmijë t'i dyfishojnë 60 deri në 90 euro. "Për herë të parë në Kosovës kemi nisur me aplikimin e shtesave nga të cilat kanë përfituar mbi 400 000 fëmijë. Kur nisëm me 10 dhe 20 euro - pati tallje e përqeshje për një politikë të këtyllë. E sot çdo familje që plotëson kushtet merr shtesa prej 30 deri 45 euro, varësisht nga numri i fëmijëve. Ndërkaq zotimi ynë është që në mandatin e plotë, të cilin e synojmë edhe një herë, shtesat për fëmijë t'i dyfishojnë 60 deri në 90 euro", tha ai. Ai tha se: "Paralelisht me këtë kemi filluar me shtesat për lehonat, nga të cilat kanë



përfituar më shumë se 80 mijë nëna. Njësoj sikurse për fëmijët, edhe këtu i patëm gjetur zero. Nisi me 170 euro muaj,

aktualisht janë 325.9 euro, por me synimin që ato të ngritën në 500 euro në muaj", tha ai. Në shënimin e Ditës

Ndërkombëtare të Familjes, ministrja e Drejtësisë në detyrë, Donika Gërvalla, theksoi se familja, si hapësira e parë ku ndërtohen siguria, solidariteti, edukimi dhe dinjiteti njerëzor, meriton vëmendje dhe mbështetje të vazhdueshme institucionale. "Për herë të parë është dyfishuar mbështetja financiare për strehimoret dhe organizatat që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, duke kaluar nga 880 mijë euro në vitin 2020 në 2.5 milionë euro në vitin 2025. Ky nuk është vetëm investim financiar, është investim në sigurinë e grave, fëmijëve dhe familjeve që kanë nevojë për mbështetje dhe mbrojtje", tha Gërvalla.

# AKK-ja: KOMUNAT NËN PRESION FINANCIAR, KËRKOHET KOMPENSIM PËR BARRËN E KONTRATËS KOLEKTIVE

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 MAJ - Këshilli i Kryetarëve i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) ka zhvilluar takimin e radhës, në të cilin është diskutuar për sfidat institucionale dhe financiare që, sipas AKK-së, po e rëndojnë funksionimin e komunave, me theks të veçantë në autonominë lokale, procedurat e rekrutimit në shërbimin civil dhe pasojat buxhetore të kontratës kolektive dhe vendimeve gjyqësore.

Takimi u hap nga kryetari i AKK-së, Agim Aliu, i cili theksoi rëndësinë e koordinimit institucional ndërmjet komunave "për mbrojtjen e interesit lokal dhe garantimin e funksionimit normal të komunave". Sipas AKK-së, në takim u shqyrtuan tri çështje kryesore: rregullorja për procedurat e pranimit në shërbimin civil, kontrata kolektive dhe pasojat financiare për komunat, si dhe ndikimi buxhetor nga zbatimi i shtesës së përvojës së punës nga 0.25 % në 0.5 %.

Asociacioni njoftoi se kryetarët e



komunave shprehën shqetësim "serioz" për, siç u cilësua, tendencën e centralizimit të kompetencave në rekrutimin e shërbyesve civilë dhe ndërhyrjen në autonominë lokale.

AKK-ja vlerëson se bartja e procedurave të rekrutimit në nivel qendror përbën cenim të kompetencave kushtetuese të komunave dhe bie ndesh me parimet e vetëqeverisjes lokale. Drejtori ekzekutiv i AKK-së, Sazan Ibrahim, sipas njoftimit, ka theksuar se komunat nuk janë konsultuar paraprakisht për ndryshimet e propozuara

dhe se janë vendosur "para një akti të kryer". Në këtë pikë, Këshilli i Kryetarëve ka kërkuar pezullimin e zbatimit të procedurave të centralizuara të rekrutimit deri në vlerësim kushtetues e institucional, inicimin e procedurës në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave që cenojnë kompetencat komunale, si dhe përfshirjen e komunave dhe AKK-së në proceset konsultative për reformën në administratën publike.

Kosto të larta nga kontrata kolektive. Në diskutimin për

kontratën kolektive, AKK-ja thotë se kryetarët kanë vlerësuar se komunat po përballen me pasojat të rënda financiare, që po ndikojnë drejtpërdrejt në projektet kapitale dhe shërbimet komunale. Sipas të dhënave të paraqitura në takim, komunat kanë përballuar mbi 344 milionë euro obligime financiare, ndërsa rreth 93 milionë euro, sipas AKK-së, kanë përfunduar në shpenzime përmbartimore.

Kryetarët, sipas njoftimit, kanë theksuar se komunat nuk janë palë nënshkruese të kontratës kolektive dhe, rrjedhimisht, "nuk duhet të bartin barrën financiare të obligimeve" të krijuara nga niveli qendror. Po ashtu, janë ngritur shqetësime për kostot e larta të përmbartuesve privatë, raste të pagesave të dyfishta dhe ndarjen e lëndëve për rritje të shpenzimeve procedurale. Në këtë drejtim, Këshilli i Kryetarëve kërkon rimbursim të mjeteve nga niveli qendror, ndërprerje të praktikave që rëndojnë buxhetet komunale përmes kostove

disproporcionale të përmbartimit, trajtim prioritar të lëndëve në sistemin gjyqësor

dhe verifikim të rasteve të pagesave të dyfishta.

Shtesa e përvojës së punës: 15-20 milionë euro kosto shtesë në vit sa i përket zbatimit të shtesës së përvojës së punës në shkallën 0.5 % pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, AKK-ja njofton se është vlerësuar se kjo po e rëndon ndjeshëm buxhetin e komunave, me një kosto shtesë prej rreth 15 deri në 20 milionë euro në vit.

Këshilli i Kryetarëve kërkon që Ministria e Financave t'i kompensojë komunat për këtë kosto shtesë dhe që obligimet financiare të krijuara nga vendimet e nivelit qendror të mos barten në buxhetet komunale pa mbështetje adekuate.

Në përfundim, AKK-ja thotë se zhvillimet e fundit ligjore, administrative dhe financiare po krijojnë vështirësi serioze në funksionimin e komunave dhe në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, duke paralajmëruar se do të ndërmerren veprime institucionale dhe juridike për mbrojtjen e interesit të komunave dhe funksionimin e qëndrueshëm të pushtetit lokal.

## Ndërron jetë ish-ministri i Shëndetësisë, Alush Gashi

PRISHTINË, 15 MAJ - Ish-ministri i Shëndetësisë, njëherësh anëtar i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Alush Gashi, ka ndërruar jetë. Lajmin e ka bërë me dije djali i tij, Anil Gashi, në rrjetin social "Facebook".

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka ngushëlluar për vdekjen e Alush Gashit, një ndër themeluesit e kësaj partie e bashkëpunëtor i ish-presidentit Ibrahim Rugova. Abdixhiku ka thënë se Gashi kishte qenë për të mentor e

këshilltar dhe e përshkroi atë si njeri i urtë e të matur. "Ishte një prej njerëzve më të afërt që pata në këtë rrugëtim. Në këtë rrugëtim timin, rrallë kam takuar njerëz me aq maturi e aq mirësi. Në momentet më të vështira, tek ai gjeja gjithmonë qetësi. Një mendim të peshuar. Një fjalë që të kthjellonte. Një përkujdesje të heshtur, pa zhurmë, pa kërkuar asgjë", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

U. d. presidentja Albulena Haxhiu ka thënë se prof. dr.

Alush Gashi i shërbeu vendit në shumë fusha dhe në periudha të rëndësishme të historisë sonë.

Ngushëllime familjes Gashi i ka shprehur edhe kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, duke theksuar se Gashi ishte ndër figurat që dhanë kontribut në ndërtim të institucioneve të vendit.

Edhe ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, i ka shprehur ngushëllime familjes Gashi. "I hidhur lajmi për humbjen e intelektualit Alush Gashi. Kontributi i tij



në arsim, shëndetësi dhe jetën publike të vendit do të mbetet i çmuar dhe i paharruar. Me përkushtimin,

urtësinë dhe punën e tij, ai la gjurmë të rëndësishme në shoqërinë tonë", ka shkruar Konjufca.

## Bedrija Ejupagić emërohet zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit

PRISHTINË, 15 MAJ - emëruar Bedrija Ejupagić në Infrastrukturës dhe dhe i dëshiroi suksese në Kryeministri në detyrë i pozitën e zëvendësministrit Transportit. Kurti e uroi përmbushjen e përgjegjësi Kosovës, Albin Kurti, ka në Ministrinë e Ejupagićin për detyrën e re të reja.



# INTEGRIMI NË SEPA PRITET TË SJELLË PAGESA MË TË SHPEJTA, MË TRANSPARENTE DHE ME KOSTO MË TË ULËT PËR QYTETARËT DHE BIZNESET

PRISHTINË, 15 MAJ - Zëvendës-guvernatori Dardan Fusha mori pjesë në panelin hapës të nivelit të lartë, i cili trajtoi perspektivën rregullative për rajonin e Ballkanit dhe prioritetet strategjike që po formësojnë të ardhmen e pagesave dhe shërbimeve financiare. Gjatë diskutimit, Fusha theksoi se transformimi i pagesave në rajon tashmë është në zhvillim aktiv përmes reformave ligjore, modernizimit të infrastrukturës së pagesave, iniciativave për interoperabilitet dhe përafrimit me standardet evropiane.

Ai veçoi rëndësinë e reformave të vazhdueshme të Kosovës në fushën e pagesave, përfshirë përparimin drejt integrimit në SEPA, zhvillimin e infrastrukturës për pagesa instant TIPS Clone, zbatimin e Ligjit të ri për Shërbimet e Pagesave dhe përgatitjet për

Open Banking. Në këtë kontekst, ai theksoi se integrimi në SEPA pritet të sjellë pagesa më të shpejta, më transparente dhe me kosto më të ulët për qytetarët dhe bizneset, duke rritur njëkohësisht qasjen, vizibilitetin dhe mundësitë e bashkëpunimit të bizneseve të Kosovës me partnerë dhe platforma ndërkombëtare, si dhe duke forcuar besimin e investitorëve dhe integrimin ekonomik me tregun evropian. Fusha, po ashtu, nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe interoperabilitetit në mbështetje të përfshirjes financiare, inovacionit, pagesave më efikase ndërkufitare dhe zhvillimit më të gjerë ekonomik, duke theksuar njëkohësisht nevojën për ruajtjen e stabilitetit financiar, qëndrueshmërisë operacionale, sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së



konsumatorit gjatë këtij procesi transformues.

Pjesëmarrja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në këtë

forum pasqyron përkushtimin e saj të vazhdueshëm për avancimin e modernizimit të pagesave, forcimin e

bashkëpunimit rajonal dhe mbështetjen e integrimit të Kosovës në infrastrukturën dhe standardet financiare evropiane.

## HARADINAJ: SIPËRMARRËSIT TANË JANË SHTYLLA E EKONOMISË



PRISHTINË, 15 MAJ - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në konferencën e organizuar nga Rrjeti Global i Bizneseve Shqiptare, me përfaqësuesit e bizneseve, me të cilët diskutuan për sfidat dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik të Kosovës si dhe për rolin e diasporës në forcimin e ekonomisë tonë dhe mbështetjen që u duhet bizneseve vendore. "Sipërmarrësit tanë janë shtylla e ekonomisë, krijojnë vende pune, mbajnë familje dhe i japin

vendit shpresë përmes punës dhe guximit për të investuar e krijuar. Aleanca ka qëndruar gjithmonë krah tyre, sepse besojmë se nuk ka shtet të fortë pa ekonomi të fortë dhe pa mbështetje për bizneset. Prandaj, programi ynë për zgjedhjet që po vijnë fokusohet në fuqizimin e ekonomisë vendore, lehtësirat fiskale, digjitalizimin dhe krijimin e një klime më të mirë për investime të huaja. Këtë program do ta jetësojmë me kandidatin tonë për kryeministër, Ardian Gjinin",

ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Haradinaj ka theksuar gjithashtu se siguria është parakusht për zhvillim ekonomik dhe se anëtarësimi në NATO mbetet objektiv strategjik për një Kosovë më të sigurt dhe më atraktive për investime. "Diaspora dhe bizneset shqiptare në botë mbeten ura jonë me tregjet dhe përvojat më të mira ndërkombëtare. Bashkëpunimi ynë është rruga për Kosovën që ecën përpara", ka shkruar Haradinaj.

## Aeroporti me rritje të udhëtarëve, hekurudha me rënie gjatë marsit 2026

PRISHTINË, 15 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e transportit dhe telekomunikimit për muajin mars 2026. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna statistikore me bazë mujore për transportin ajror, hekurudhorë dhe telekomunikimin.

Në muajin mars 2026 numri i fluturimeve të realizuara ishte 1 082, ose 1,7 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 338 528

ose 5,9 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (mars 2025).

Në muajin mars 2026 numri i udhëtarëve në hekurudha ishte 6 844 ose (-5,1 %) më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit 2025, ndërsa mallra të transportuara përmes hekurudhës nuk kishte në këtë muaj.

Në muajin mars 2026 numri i përdoruesve në rrjetin e telefonisë fikse ishte 69 418, me një rritje prej 2,8 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të

kaluar. Ndërsa trafiku i realizuar (në minuta) ishte 1 881 577, me një rënie prej (-3,6 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në muajin mars 2026 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 523 630 ose 2,31 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 321 455 mije ose 2,42 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



# PAS GJERMANISË E 'PËSON' EDHE POLONIA, PENTAGONI NGRIN VENDOSJEN E 4000 TRUPAVE AMERIKANË NË VEND

Pentagoni ka anuluar planet për të vendosur përkohësisht 4,000 trupa amerikane në Poloni, thanë dy zyrtarë amerikanë për Reuters, në një veprim të papritur që ngre pyetje në lidhje me shkurtimet e afërta të trupave amerikanë nga Presidenti Donald Trump në Evropë.

Një zëdhënës i Pentagonit nuk pranoi të komentojë për Reuters, ndërsa një senator amerikan tha se Kongresi nuk ishte informuar ende zyrtarisht për vendimin. Nuk ka pasur asnjë koment të menjëhershëm nga administrata.

Vendimi, i raportuar për herë të parë nga Army Times, vjen vetëm dy javë pasi Pentagoni njoftoi se po tërhiqte 5,000 trupa nga Gjermania, pjesërisht për shkak të një përçarjeje midis Trump dhe Evropës për shkak të luftës me Iranin.

Një zyrtar amerikan, duke folur për Reuters në kushte anonimiteti, tha se vendimi për Poloninë ishte pjesë e një zgjidhjeje afatshkurtër që përfundimisht do të lejonte një tërheqje të forcave në Gjermani, ku aktualisht janë të stacionuara rreth 35,000 trupa amerikane.

Kjo mund të nënkuptojë që trupat që do të zhvendoseshin përkohësisht në Poloni mund të vinin përfundimisht nga

vende të tjera.

Ndërkohë, Shtetet e Bashkuara kanë kohë që po rishikojnë praninë e tyre ushtarake në Evropë dhe pritet ta zvogëlojnë atë, ndërsa Trump kërkon që NATO të marrë një rol më të madh në mbrojtjen e kontinentit.

Megjithatë, Pentagoni ende nuk ka detajuar se si planifikon vendosjen e ardhshme të forcave amerikane në Evropë.

Trump thuhet gjithashtu se është i zemëruar që aleatët evropianë nuk iu bashkuan luftës kundër Iranit dhe u përplas me kancelarin gjerman Friedrich Merz, i cili muajin e kaluar tha se iranienët po i "poshtëronin" Shtetet e Bashkuara në negociata.

Senatorja demokrate Jeanne Shaheen, anëtare e Komitetit të Shërbimeve të Armatosura të Senatit, u tha gazetarëve se vendimi për Poloninë duket se e ka zënë në befasi edhe Kongresin. "Sipas njohurive të mia, ne nuk ishim të informuar për këtë", tha ajo.

Kur u njoftua tërheqja e trupave nga Gjermania, një zyrtar i lartë amerikan kishte thënë se ky veprim do t'i rikthente nivelet e forcave amerikane në Evropë në nivelet afërsisht para vitit 2022, para pushtimit të Ukrainës nga Rusia, gjë që e kishte shtyrë Presidentin e atëhershëm Joe



Biden të rriste praninë amerikane.

Tërheqjet e fundit të trupave vijnë gjithashtu në një kohë kur Uashingtoni po rrit presionin mbi vendet evropiane për të rritur shpenzimet e mbrojtjes, duke i akuzuar ato për neglizhencë ndaj ushtrive të tyre për shkak të mbështetjes së tyre në forcat amerikane.

Reuters kishte zbuluar një email të brendshëm të Pentagonit muajin e kaluar, i cili paraqiste mundësi për "ndëshkimin" e aleatëve të NATO-s që, sipas Uashingtonit, nuk mbështetën operacionet

amerikane në luftën me Iranin. Këto mundësi përfshinin pezullimin e anëtarësimit të Spanjës në NATO dhe rishqyrtimin e qëndrimit të SHBA-së mbi sovranitetin britanik mbi Ishujt Falkland.

Të shqetësuar nga kritikata e përsëritura të Trump ndaj NATO-s, ligjvënësit nga të dyja partitë vitin e kaluar mbështetën një dispozitë në Aktin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare të SHBA-së (NDAA) që do të ndalonte reduktimin e trupave amerikane në Evropë nën 76,000.

Trump nënshkroi dispozitën në

dhjetor, por administrata ka pak hapësirë për fleksibilitet.

Dispozita e NDAA-së i lejon presidentit të zvogëlojë forcat nën pragun prej 76,000 trupash, me kusht që ai të vërtetojë se është konsultuar me aleatët e NATO-s dhe të paraqesë vlerësime të pavarura se si një vendim i tillë do të ndikonte në sigurinë e SHBA-së, kohezionin e aleancës dhe parandalimin e agresionit rus. Në fund të vitit të kaluar, kishte rreth 85,000 trupa amerikane në Evropë.

## KREU I CIA-S TAKON ZYRTARËT KUBANË NË HAVANA, ZBULOHEK NDIHMA E OFRUAR NGA SHBA NË MES TË KRIZËS SË NAFTËS

Drejtori i CIA-s, John Ratcliffe, është takuar me homologun e tij kubanë në Ministrinë e Brendshme në Havanë, pasi SHBA rinovoi ofertën prej 100 milionë dollarësh ndihmë për të lehtësuar efektet e bllokadës së naftës ndaj vendit.

Kuba tha përmes një deklaratë se takimi ishte një përpjekje për të përmirësuar dialogun dhe se zyrtarëve amerikanë iu tha se Havana nuk përbën kërcënim për sigurinë kombëtare të SHBA-së.

Një zyrtar i CIA-s i tha CBS News, se SHBA-ja është "e gatshme të angazhohet seriozisht për çështjet ekonomike dhe të sigurisë, por vetëm nëse Kuba bën ndryshime themelore".

Mungesat e karburantit, të përkeqësuar nga bllokada amerikane e naftës ndaj vendit, kanë bërë që spitalet të mos funksionojnë normalisht dhe



kanë detyruar mbylljen e shkollave dhe zyrave qeveritare. Veçmas, presidenti kuban Miguel Díaz-Canel tha se, në vend që të ofronte ndihmë,

kushtet mund të përmirësoheshin më shpejt nëse SHBA do të hiqte bllokadën ndaj Kubës.

Sipas zyrtarit të CIA-s, në takim

morën pjesë edhe Raúl Rodríguez Castro, nipi i ish-presidentit Raúl Castro, ministri i Brendshëm Lázaro Álvarez Casas, si edhe drejtuesi i

shërbimeve sekrete kubaneze.

Delegacioni u takua "për të përcjellë personalisht mesazhin e Presidentit Trump", tha zyrtari i CIA-s. "Gjatë takimit, drejtori Ratcliffe dhe zyrtarët kubanë diskutuan për bashkëpunimin në fushën e inteligjencës, stabilitetin ekonomik dhe çështjet e sigurisë, të gjitha në sfondin se Kuba nuk mund të jetë më një strehë e sigurt për kundërshtarët në Hemisferën Perëndimore", shtoi zyrtari.

Deklarata kubaneze tha: "Të dyja palët nënvizuan gjithashtu interesin për zhvillimin e bashkëpunimit dypalësh mes agjencive të zbatimit të ligjit në interes të sigurisë së të dy vendeve, si dhe të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare."

Cuba dhe SHBA pranuan më herët këtë vit se ishin në bisedime, por negociatat duket se ngecën ndërsa bllokada e naftës vazhonte.

# ARTHUR MILLERI, DRAMATURGJIA, KOMUNIZMI DHE MARTESA ME MARILYN MONROEN

**BISEDAT E INCIZUARA MBULOJNË GJITHASHTU MARRËDHËNIEN E DRAMATURGUT ME FAMËN, DYSHIMIN TE VETVETJA DHE KOMUNIZMIN**

Nga: Donna FERGUSON / **The Telegraph** (titulli: *Arthur Miller opens up about marriage to Marilyn Monroe in newly unearthed recordings*)

Ishte një nga dramaturgët më të mëdhenj të shekullit XX dhe ajo ishte një nga aktoret më të mëdha. Në incizimet e zbuluara së fundmi, të realizuara përgjatë gati tri dekadave, Arthur Milleri foli haptazi për martesën e tij jetëshkurtër me Marilyn Monroen, duke thënë se ajo kërkonte një bashkëshort që të ishte “baba, i dashur, mik dhe agjent,” ndërsa fëmija që ajo dëshironte aq shumë do të kishte qenë “problem shtesë.”

Në bisedat e incizuara me mikun dhe biografën e tij, profesorin Christopher Bigsby, Milleri tha se kishte ndier se “vdekja ishte gjithmonë mbi supin e saj [të Monroes] - gjithmonë.” Ai kishte besuar se, nëse nuk “kujdesej për jetën e saj,” ajo do të arrinte në një “fund shkatërrimtar.”

“Në një rast solla mjekët për ta shpëtuar, sepse kishte gëlltitur mjaftueshëm substanca [ilaçe] për të vranë veten,” tha ai. “Kështu që ndjeva se ishte në një gjendje shumë delikate psikologjike. Siç doli, u deshën disa vite, por ndodhi. Ishte përtej fuqisë sime apo të kujtudo tjetër për ta ndaluar.”

nuk do ta kritikonte kurrë për asgjë, përndryshe do të humbiste besimin në vetvete. Nuk e di nëse ekziston një qenie e tillë njerëzore.”

Pas një aborti spontan dhe një shtatzënie jashtë mitre të Monroes, çifti kërkoi pa sukses për ndihmë mjekësore, zbulojnë incizimet. Duke reflektuar mbi humbjen e tyre, Milleri tha se ndiente që Monroe donte të bëhej nënë “në një mënyrë ideale,” ndërkohë që punonte nën “presion të jashtëzakonshëm” në Holivud: “Në njëfarë mënyre, nuk jam i sigurt se sa mirë do të kishte qenë për të të kishte fëmijë. Do të ishte problem shtesë ... Nuk jam i sigurt si do të kishte funksionuar në praktikë.”

Ai e përshkroi Monroen si “të këndshme për të qenë me të” dhe “një grua shumë inteligjente” që kishte “një ndjenjë të jashtëzakonshme humori, ironie dhe bujari,” por tha se më pas e pushtoi “një lloj paranoje.” “Ajo filloi të dyshonte te të gjithë, sikur po e shfrytëzonin ose po e dëmtonin.”

Çifti u largua plotësisht nga njëri-tjetri teksa Monroe po luante në filmin *Të papërshtatshmit* [The Misfits], të shkruar nga Milleri për të, në vitin 1960. Ata filluan të grindeshin vetëm disa muaj pas martesës, kur Monroe po xhironte Princin dhe valltaren



kishin ndryshuar, ai gjithsesi do t'i kishte dhënë fund martesës në atë moment. “Nuk mund të vazhdoja më. Do të më kishte shkatërruar. Nuk mund të punoja më.”

Bisedat e papublikuara më herët u incizuan përgjatë afro 30 vjetëve, duke filluar pak pasi Milleri u takua me Bigsbyn në mesin e viteve '70 të shekullit XX dhe duke vazhduar deri disa vite para vdekjes së dramaturgut - fitues i çmimit Pulitzer - në vitin 2005. Ato dolën në dritë pasi Bigsby, tashmë 84 vjeç, i transkriptoi për librin *Kasetat e Arthur Millerit: Jeta me fjalët e tij* [The Arthur Miller Tapes: A Life in His Own Words], botuar të enjten nga [Shtëpia Botuese] Cambridge University Press.

Milleri zbuloi gjithashtu se si suksesi i jashtëzakonshëm i Vdekja e shitësit [Death of a Salesman] në vitin 1949 - drama e parë në teatrin amerikan që fitoi një çmim të Critics' Circle, një Tony dhe një Pulitzer - njëkohësisht e fuqizoi atë dhe kontribuoi në prishjen e martesës së tij të parë me Mary Slattery. “Horizonti im papritur u hap drejt shumë mënyrave të tjera për të shprehur dominimin tim. Ndihesha sikur mund të bëja gjithçka, dhe mendoj se aty

filluam të largoheshim nga njëri-tjetri.”

Ai i tha Bigsbyt se fama “është një formë pushteti që është seksual, ose në mënyrë të nënkuptuar seksual.” Tha se ishte “zhytur plotësisht” në punën e tij, “gjatë gjithë ditës dhe gjithë natës.”

“Tani që kujtoj, nuk e di se si mund të jetonte dikush me mua.” Në të njëjtën kohë, gjatë gjithë jetës së tij ai kishte vënë në dyshim aftësinë e vet për të shkruar, pranoi ai. “E gjithë jeta ime ka qenë një luftë me dyshimin për veten.” Vetëm një “përqindje e vogël” e asaj që kishte shkruar “kishte parë ndonjëherë dritën e botimit,” zbuloi ai.

Milleri foli gjithashtu për flirtin e tij me komunizmin dhe për ndalimin e veprës së tij nga Holivudi pasi refuzoi të identifikonte shkrimtarët komunistë përpara Komitetit të Dhomës së Përfaqësuesve për Aktivitetet Jo-Amerikane në vitin 1956.

Ai tha se makartizmi krijoi “një lloj ndjesie irracionale të një frike të vazhdueshme se një forcë e padukshme kishte depërtuar në shoqëri dhe po hapte vrima në të për ta rrëzuar. Nuk kishte asnjë mënyrë racionale për t'u përballur me gjithë këtë, sepse sa

herë që përpiqeshe ta bëje, mund të akuzoheshe se ishe pjesë e atij komploti.”

Ai kishte frikë se ai dhe njerëzit e tjerë “me mendime kundërshtuese” do të përfundonin “ose në një spital psikiatrik, ose në një lloj sistemi gjysmë-fashist,” duke censuruar veten ndërsa “njerëzit më ekstremë patriotikë do të drejtonin gjithçka.” “Kjo ishte një nga arsyet pse fillova të shkruaja *Sprovat e rënda* [The Crucible]. Duhej të gjeja një mënyrë për ta trajtuar [atë],” tha ai.

Ai e vendosi dramën gjatë gjyqeve të shtrigave në Salem sepse “ishte thjesht e pamundur të diskutohet ajo që po na ndodhte me terma bashkëkohorë. Duhej të krijohej njëfarë distance ndaj fenomenit. Të gjithë po çmendeshim paksa duke u përpjekur të ishim të ndershëm, të shihnim qartë dhe të qëndronim të sigurt.”

Në incizime, Miller foli gjithashtu për fëmijërinë e tij, përvojën e tij të parë seksuale në një bordello në moshën 16-vjeçare, pikëpamjet e tij mbi sionizmin dhe antisemitizmin si hebre ateist, frymëzimin për Të papërshtatshmit dhe shumë nga dramat e tij, ndikimin e Holokaustit në veprën e tij, si dhe martesën 40-vjeçare me gruan e tij të tretë, Inge Morath.

Bigsby, i cili është profesor emeritus i studimeve amerikane në Universitetin e Ist Anglisë, mendon se idetë dhe përvojat që formësuat jetën dhe karrierën e Millerit bëjnë që dramat e tij të mbeten shumë të rëndësishme edhe sot. “Ai flet për hebraizmin e tij si ndjeshmëri, si shqetësim i vazhdueshëm për brishtësinë e shoqërisë të cilën e mësoi nga Depresioni i Madh dhe e mësoi sërish nga Holokausti, se ne ecim mbi akull shumë të hollë në ndjesinë tonë të qytetërimit,” tha ai. “E gjithë kjo është bazike për Millerin. Ai është një njeri që beson në rëndësinë e historisë, në lidhjen mes së kaluarës dhe së tashmes, sepse kjo është baza e moralit.” /Telegrafi/



Në shtëpinë e Millerit në Roksbëri të Konektikatit, në vitin 1956, disa orë para dasmës së tyre. Foto: Bettmann Archive

Vdekja e Monroes nga mbidoza e barbiturateve në vitin 1962, në moshën 36-vjeçare, i ishte dukur e pashmangshme. “Ishte e pamundur për të të jetonte, e lëre më me këdo tjetër. Nuk mund të vazhdoje me atë intensitet jete dhe me ato ilaçe e të mbijetoje,” tha ai.


Çifti nisi një lidhje pasionante jashtëmartesore në vitin 1955 dhe u martua në vitin 1956. Milleri tha se iu deshën vetëm disa muaj për ta kuptuar se kishte gabuar. “Nuk isha vërtet i përgatitur për atë për të cilën duhej të isha përgatitur e që ishte fakti se ajo, fjalëpërfjalshëm, nuk kishte burime të brendshme ... Ajo kërkonte një baba, një të dashur, mik, agjent, mbi të gjitha dikë që

[The Prince and the Showgirl]: “U përfshimë në një debat nëse [regjisori, Laurence] Olivier po e persekutonte atë ... Përfundova duke e mbrojtur atë, dhe kjo ishte gjëja më e keqe që mund të kisha bërë. Por, nuk besoj se ndonjë rrugë tjetër do të kishte rëndësi.” Në kohën kur ai u largua nga xhirimet e Të papërshtatshmit, martesë e tyre praktikisht kishte marrë fund, tha ai. “Nuk flisnim më. Nuk kishte asnjë mënyrë për t'iu afruar asaj ... Ajo ishte vërtet armiqësore ndaj meje.”

Nga këndvështrimi i karrierës, ai ndiente se kishte kaluar katër vjetët e martesës së tyre “duke mos bërë në thelb asgjë,” përveç Të papërshtatshmit, dhe se edhe nëse ndjenjat e Monroes do të



Në shtëpinë e Millerit në Roksbëri të Konektikatit, në vitin 1956, disa orë para dasmës së tyre. Foto: Bettmann Archive



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

## Nesër luhen të gjitha ndeshjet e xhiros së 34-t në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka publikuar orarin e ndeshjeve të xhiros së 34-t në Superligën e Kosovës. Në orarin e publikuar në sajtin zyrtar të FFK-së është bërë me

dije se të gjitha ndeshjet e kësaj xhiroje do të luhen në ditën e njëjtë dhe do të fillojnë në orën e njëjtë. Pra, kjo xhiro do të zhvillohet nesër (e diel), ndërsa ndeshjet do të

fillojnë nga ora 16:00. Të gjitha ndeshjet pritet të jenë interesante, duke pasur parasysh se vazhdon gara për mbijetesë kur kanë mbetur edhe tri xhiro deri në fund të sezonit.

Malisheva - Drenica, Dukagjini - Drita, Prishtina - Ferizaj, Gjilani - Llapi dhe Ballkani - Prishtina e Re, janë çiftet e xhiros së 34-t në elitën e futbollit të Kosovës.



## KOSOVA DHE SHQIPËRIA SHTOJNË BASHKËPUNIMIN PËR LOJËRAT MESDHEWARE "PRISHTINA 2030"

PRISHTINË, 15 MAJ - Presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Fidel Ylli, ka pritur në një takim pune drejtuesit e lartë të institucioneve olimpike ndërkombëtare dhe rajonale, në kuadër të përgatitjeve për organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030". Në takim kanë marrë pjesë presidenti i Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030", njëherësh presidenti i Komitetit Olimpik të Maltës, Julian Pace Bonello, sekretari i përgjithshëm i ICMG-së, Iakovos Filippousis, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, zëvendëspresidenti Milaim Kelmendi dhe këshilltari i ministrit të Sportit të Kosovës, Drilon Brahimi. Takimi është zhvilluar në kuadër të inspektimeve dhe koordinimit për përgatitjet e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030",

event që konsiderohet historik për sportin në Kosovë dhe rajon. Në këtë organizim Durrësi do të ketë rol të rëndësishëm si qytet mbështetës për zhvillimin e të gjitha sporteve ujore. Gjatë takimit presidenti Fidel Ylli ka prezantuar zhvillimet dhe arritjet e sportit shqiptar në vitet e fundit, duke u ndalur te transformimi i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe investimet në infrastrukturë sportive, organizim dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Ndërsa presidenti Julian Pace Bonello është shprehur i impresionuar nga mikpritja dhe progresi i sportit shqiptar, duke vlerësuar mbështetjen dhe bashkëpunimin strategjik për suksesin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030". Ndërkaq sekretari i përgjithshëm i ICMG-së, Iakovos Filippousis, ka vlerësuar kontributin e Fidel Yllit




në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve olimpike dhe në zhvillimin e sportit në rajon. Edhe presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka çmuar mbështetjen e vazhdueshme të Fidel Yllit ndaj Kosovës, duke theksuar se vizioni, energjia dhe përkushtimi i tij mbeten frymëzim për

komunitetin sportiv shqiptar. Takimi ka konfirmuar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë për organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030", me synimin që ky event të shndërrohet në një prej organizimeve më të rëndësishme sportive në rajon dhe në Mesdhe.

## Kandidati për president të Fenerbahçes premton 200 milionë euro dhe kthimin e Muriqit

STAMBOLL, 15 MAJ - Aziz Yildirim vlerësohet pretendent i fortë për president të gjigantit turk të futbollit, Fenerbahçe. Dhe mediet turke kanë shkruar të premtën se Yildirim ka plan për investim prej 200 milionë eurosh në skuadrën e Fenerit. Ndër të tjera, ai planifikon forcimin e sulmit me Vedat Muriqin dhe Alexander Sorlothin. Fenerbahçe ka mbetur në hije të Galatasarayt në vitet e fundit, ndërsa tifozët e zjarrtë të kësaj skuadre presin shumë nga zgjedhjet që do të mbahen në fillim të qershorit. Muriqi ka shkëlqyer për Mallorcan në La Liga, duke i realizuar 22 gola. Yildirim ka drejtuar më herët Fenerbahçen dhe ishte president i suksesshëm.



## DAVID BECKHAM BËHET SPORTISTI I PARË MILIARDER NË BRITANI

LONDËR, 15 MAJ - Ish-kapiteni i Anglisë, David Beckham, është bërë sportisti i parë britanik miliarder në listën e pasurisë së "Sunday Times Rich List 2026". Sipas përpiluesve të listës, pasuria e përbashkët e Beckhamit dhe bashkëshortes së tij, Victoria Beckham, ka arritur në 1.185 miliard funte. Kjo i vendos ata në vendin e dytë mes figurave sportive, pas familjes së ish-shefit të "Formula One", Bernie Ecclestone, pasuria e të cilit vlerësohet në 2 miliardë funte. Golfisti nga Irlanda e Veriut, Rory McIlroy, renditet i shtati me 325 milionë funte, pasi 37-vjeçari është shpallur kampion i Masters për të dytin vit radhazi. Ndërkohë bashkëpronari i



Manchester United FC, Jim Ratcliffe, ka rënë nga vendi i shtatë në të nëntin në renditjen e përgjithshme në Mbretërinë e Bashkuar, pasi pasuria e tij është ulur me 1.85 miliard funte, duke zbritur në 15.194 miliardë funte. Beckhami, ish-mesfushor i Manchester Unitedit, tani është bashkëpronar i klubit amerikan

Inter Miami CF, i cili vlerësohet si skuadra më e vlefshme në Major League Soccer me një vlerë prej 1.45 miliardë dollarësh (1.07 miliardë funte). 51-vjeçari, i cili ka marrë titullin "Sir" në nëntor, është gjithashtu ambasador i markave të njohura si "Adidas" dhe "Hugo Boss". Pasuria e Victoria Beckhamit është krijuar kryesisht nga marka e saj e modës, pasi më parë ishte bërë e famshme si anëtare e grupit muzikor "Spice Girls". Promotorët Barry Hearn dhe Eddie Hearn janë bërë gjithashtu pjesë e klubit të miliardërëve britanikë, me pasurinë e tyre të përbashkët që vlerësohet në 1.035 miliard funte. Barry Hearn është

themelues dhe president i "Matchroom Sport", një nga kompanitë kryesore në promovimin e boksit, dartit dhe snookerit. Djali i tij, Eddie Hearn, është kryetar i "Matchroom" dhe promotori i boksierit britanik, Anthony Joshua, i cili renditet sportisti i tetë më i pasur në listë me 240 milionë funte, një vend mbi rivalin e tij në peshat e rënda, Tyson Fury, me 162 milionë funte. Shtatë herë kampioni i "Formula 1", Lewis Hamilton, renditet i pesti me 435 milionë funte, ndërsa kapiteni i Anglisë, Harry Kane, dhe dy herë kampioni i "Wimbledon Championships", Andy Murray, ndajnë vendin e dhjetë me nga 110 milionë funte secili.

## Conte drejt shkarkimit nga Napoli, Real Madridi vëzhgon situatën

NAPLES, 15 MAJ - Të ardhmes së Antonio Contes te Napoli po i vjen fundi. Ndonëse projekti kishte nisur me synime të mëdha, dështimi në Ligën e Kampionëve

(eliminimi në grupe) dhe distanca prej 15 pikësh nga kreu i Serisë A kanë thyer marrëdhënien mes trajnerit dhe drejtuesve. Tensionet e brendshme dhe

pakënaqësitë për merkaton kanë bërë që shkarkimi në fund të sezonit të jetë thuajse i pashmangshëm. Ky lajm ka alarmuar Real Madridin, ndonëse nuk

është favoriti kryesor, statusi i Contes si trajner i lirë e bën atë një opsion serioz për stolin e "Los Blancos" nëse vendosin për ndryshime gjatë verës.





REPUBLIKA E KOSOVËS-REBUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KS

**Ndërmarrja Publike Lokale  
"Stacioni i Autobusëve" Sh.A.****FERIZAJ**

Kryeshefi Ekzekutiv e N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A – Ferizaj, në bazë të nenit 16 pika 1 të Statutit të kompanisë, Ligjit të Punës Nr.03/L-212, neni 8 dhe 10, si dhe Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës dhe Organogramit të ndërmarrjes, lidhur me plotësimin e vendeve të punës, shpall:

**KONKURS**

ME KOHË TË CAKTUAR I (NJË) VIT ME MUNDËSI VAZHDIMI

**POZITA I****Zyrtar/e i/e Burimeve Njerëzore**

Kualifikimi arsimor:

- Diplomë universitare në Juridik, Administratë Publike, Menaxhment Ekonomik ose fusha të ngjashme.

Përvoja e punës:

- 5 vite përvojë pune .

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Administrimi i dosjeve të personelit
- Përgatitja e kontratave dhe dokumenteve administrative
- Menaxhimi i evidencave të stafit
- Mbështetja e procedurave të rekrutimit
- Zbatimi i procedurave të brendshme dhe legjislacionit të punës dhe të tjera.

**Kualifikimet dhe dokumentacioni i përgjithshëm:**

- Kërkesa për punësim dhe CV
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipit
- Shkathtësi të mira komunikuese
- Njohuri në përdorimin e kompjuterit
- Certifikatë kompjuterike nga institucion kredibil
- Dëshmi se kandidati/ja nuk është nën hetime

Vlerësimi dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim. Lartësia e pagës përcaktohet në harmoni me politikat e kompanisë. Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionin në zyrat e kompanisë N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A – Ferizaj dhe po në të njëjtin vend mund t'i dorëzojnë aplikacionet. Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret në shqyrtim. Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë pas seleksionimit të dokumentacionit.

**Afati për aplikim:** 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit, nga ora 08:00 deri 16:00.

Ferizaj, 15.05.2026

Kryeshefi Ekzekutiv  
Denis Rashiti





Prishtinë, 07.05.2026

**NJOFTIM PUBLIK**

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812109454 me adresë: Rr. „Mazllam Kastrati, Tranziti i Vjetër“ pn, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 14.04.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panellet solare me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës.

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.4363-2/25 dt. 18.08.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimin Nr. 04-353/01-21408 të dt. 07.03.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Aktvendimin nr. 04-353/01-135622 të dt. 10.10.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Nr.04-353/01-22408 dt. 19.03.2026, për "Vendosjen e paneleve solare fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 1 MW, ngastrata katastrale 00142-1 ZK Petrovë, gjegjësisht në objektin me nr. 24-0 ZK Petrovë, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 4131 dt. 24.03.2026 të lëshuar nga KEDS SLLA.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund të paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronikë: [luan@ild-prizren.com](mailto:luan@ild-prizren.com), [erzen.krasniqi@solar2.eu](mailto:erzen.krasniqi@solar2.eu) dhe [LEGAL-LEECENSING@cro-ks.org](mailto:LEGAL-LEECENSING@cro-ks.org)

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Elza Bicurri B.I. D.P.T. "Charlie-N" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811146209.
- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.
- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U "Engjëll Gjoni", Novosellë, nga klasa 1-8.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Baçelor i Edukimit Fillor.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Salihi Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 marsi" Prizren.
- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfm " Zef Lush Marku" Velezhe.
- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfm " Zef Lush Marku " Velezhe.
- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

